



Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

---

# Raporti vjetor 2012

Janar 2013



**Përmbajtja:**

☛ Realizimi i planit të trajnimit në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare .....	1
☛ Objektivat kryesorë strategjikë të zhvillimit institucional .....	5
☛ Programi i trajnimit për vitin 2012 .....	7
☛ Mbështetje Institucionale dhe Financiare .....	12
☛ Donatore dhe bashkëpunime me projekte.....	15
☛ Bashkëpunimi me Institucione Kombëtare dhe Ndërkombëtare...	15
☛ Rritja e kapaciteve të ITAP.....	17
☛ Shpenzimet e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.....	18
☛ Vlerësime dhe të Dhëna të Përgjithshme .....	19
☛ Përfundime.....	20
☛ Lista e trajnimeve të zhvilluara gjatë vitit 2012.....	22



## **Realizimi i planit të trajnimit në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare**

Gjatë vitit 2012 Instituti i Trajnimit të Administratës Publike ka zhvilluar veprimtarinë e tij bazuar në planin strategjik 2011-2013, hartuar në përputhje me SKZHI-në që është baza për realizimin e planit të punës dhe vendosjen e objektivave institucionale.

⇒ ITAP i ka kushtuar rëndësi të veçantë organizimit të aktiviteteve për trajnimin e administratës publike në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë. Vendi ynë si vend që përgatitet për anëtarësim në Bashkimin Europian duhet që t'i çojë institucionet, sistemet administrative dhe kapacitetet menaxhuese në ato standarde që sigurojnë zbatimin efektiv të *acquis communautaire*. E parë në këtë këndvështrim aktivitetet trajnuese janë orientuar:

### **o Barazia Gjinore**

Për zbatimin e politikave gjinore, mjedisi institucional luan një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të burrave dhe grave, sidomos në zbatimin e politikave që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë. Instituti i trajnimit të administratës publike, në bashkëpunim me donatorë si edhe me fondet e buxhetit të shtetit ka organizuar trajnime në nivel qendror dhe lokal, aktivitete me tematika si: Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, Aspekti gjinor në planifikimin urban etj. Gjatë vitit 2012 janë zhvilluar 11 kurse, 12 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 262 nëpunës civilë.

### **o Lufta kundër korrupsionit**

-Raporti i Progresit i Komisionit Europian vlerëson përpjekjet e ndërmarra, thekson një përmirësim të perceptimit të luftës kundër korrupsionit. Në këtë këndvështrim ITAP në bashkëpunim me donatore dhe ILDKP-në ka zhvilluar trajnimë me tematika: Etika dhe antikorrupsioni, Etika dhe zbatimi i ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, Deklarimi i pasurive dhe parandalimi i konfliktit të interesit, Ligji i konkurrencës në prokurimet publike, Prokurimi dhe Auditimi si element kyç në menaxhimin e fondeve etj.

Kështu janë zhvilluar në nivel qendror dhe lokal rreth 35 kurse, 45 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 640 nëpunës civilë.



o **Decentralizimi**

Gjatë vitit 2012 fokusi ka qenë thellimi dhe zgjerimi i procesit të decentralizimit të pushtetit vendor, përmes forcimit të nivelit të parë të qeverisjes vendore.

Gjatë kësaj kohe është punuar për zhvillimin e trajnimeve me tematika si :Menaxhimi i financave vendore të cilat kompletonjnë më tej objektivat e ligjit mbi menaxhimin e buxhetit.

o **Mjedisi**

Në zbatimin e reformave dhe politikave mjedisore për të ruajtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, promovuar vlerat mjedisore dhe forcuar sistemin e monitorimit të mjedisit, vëmendje i është kushtuar rritjes së kapaciteteve për monitorimin dhe formulimin e politikave dhe masave për të parandaluar degradimin dhe ndotjen e mjedisit.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2012 ITAP-i, mbështetur nga buxheti i shtetit, ka hartuar kurrikulën me temë: Menaxhimi i mbetjeve urbane. Ky trajnim u hartua për nëpunës të nivelit të qeverisjes vendore, të cilët janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të mjedisit. Trajnimi u zhvillua në Elbasan, Fier , Tiranë dhe u trajnuan 63 nëpunës civilë. Ky trajnimi do të përfshihet edhe në planin e trajnimeve të vitit në vazhdim.

o **Politika dhe përfshirja sociale**

Vendi ynë ka një potencial të lartë të disponueshëm të forcave të punës në moshën më produktive për punë. Krijimi i vendeve të reja të punës përbën një prej sfidave më komplekse e cila kërkon mbështetjen me politika stimuluese makro-ekonomike, një klimë të favorshme për zhvillimin e biznesit si dhe politika të shëndosha e të qëndrueshme arsimore.

Në mbështetje të këtij prioriteti ITAP-i në bashkëpunim me UNDP-në ka zhvilluar një sërë trajnimesh me temë :Sistemi i monitorimit të raportimit të indikatorëve të planit të veprimit për dakadën e romëve. Ky trajnim është zhvilluar 8 herë dhe janë trajnuar 141 nëpunës civilë. Gjithashtu gjatë vitit 2012 po në bashkëpunim me UNDP-në, është zhvilluar edhe trajnimi me temë : Aksueshmeria për personat me aftësi të kufizuara dhe realizimi i saj , Njohje me legjislacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar migrator etj.

⇒ Veprimtaria e ITAP, përveçse ka mbështetur prioritete e mësipërme, ka synuar të përmbushë edhe objektivat e zhvillimit Institucional dhe strategjikë,të cilët janë përcaktuar qartë në planin strategjik 2011-2013.

Aktivitetet trajnuese të ITAP-it edhe për vitin 2012 u financua nga Buxheti i Shtetit dhe u plotësuan edhe nga fondet e donatorëve. Këto fonde u përdorën për financimin e



drejtpërdrejtë të kurseve të trajnimit, gjithashtu dhe për hartimin e kurrikulave të reja. **Objektivat kryesorë strategjikë të zhvillimit institucional**

Objektivat kryesorë strategjikë për vitin 2012, të cilat synuan ta orientonin ITAP-in më shumë drejt klientit duke e bërë atë më aktiv në përmbushjen e vizionit dhe misionit të tij, janë si më poshtë:

✓ ***Shndërrimi i ITAP-it në një institucion të orientuar më shumë drejt klientit.***

ITAP ka diskutuar vazhdimisht me menaxherët e burimeve njerëzore çështje me interes të përbashkët, duke prezantuar vazhdimisht programet e trajnimit dhe diskutuar me ta përpuethshmërinë e tyre me nevojat reale.

Për realizimin e këtij objekti është punuar në:

- Përdorimin me efektivitet të kapaciteteve logjistike të ITAP
  - Forcimin e rolit dhe funksioneve të menaxherit të trajnimit
  - Forcimin e kontrollit të cilësisë të zhvillimit të trajnimit
  - Rritjen e kapaciteteve të brendshme të ITAP, me qëllim përfshirjen e vetë stafit të ITAP-it në zhvillimin e disa programeve bazike të trajnimit.
- ✓ ***Përmirësimi i organizimit të brendshëm të ITAP me qëllim ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e trajnimeve në nivel strategjik, në kuadër të SKZHI-së dhe MSA -së.***

Në kushtet kur nevojat për trajnim janë vazhdimisht në zhvillim, bazuar edhe në programet dhe reformat e ndërmarra nga Qeveria, është e rëndësishme të theksojmë se ITAP-i ka luajtur një rol të rëndësishëm duke marrë pjesë në diskutime, duke këshilluar dhe mësuar nga komentet (feedback) si dhe ka hartuar dhe zbatuar plane afatgjata për rritjen e kapaciteteve.

✓ ***Rritja e rolit të ITAP-it në zhvillimin e programeve të trajnimit të financuara nga ndihma e huaj.***

Gjatë kësaj periudhe, ITAP ka punuar në bashkëpunimin me projekte të financuara nga donatorë, duke zhvilluar trajnime në bashkëpunim me projekte dhe donatorë:

- "Procect Preparation Facilities" PPF,
- "Decentralized management System" DMS,
- "Support to the EU Integration Process" SMEI III,
- "Support for the Implementation of EU – compliant Albanian Legislacion" - GIZ
- "Gender Responsive Budgeting" – UNĒOMEN
- "Support the Expansion of the Albanian Treasury System" - SETS.




## Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

- “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit-“ GIZ GmbH
- “Organisation for Security and Cooperation in Europe” - OSCE
- “United Nation Deveopement Programm”- UNDP

Në organizimin e këtyre trajnimeve ITAP ka qenë jo vetem partner por edhe koordinator në kuadër të bashkërendimit të trajnimeve. Kjo ka sjellë edhe një përdorim më racional të burimeve nga Buxheti i Shtetit, të cilat janë orientuar për trajnimet më të domosdoshme për Administratën Publike, ne bazë të nevojave të tyre specifike.

**Gjatë këtij viti, janë organizuar 74 kurse në bashkëpunim me projekte dhe donatorë, 132 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 1347 nëpunës civilë.**

E paraqitur grafikisht, pesha specifike e trajnimeve të zhvilluara në bashkëpunim me këto projekte dhe donatorë, paraqitet si më poshtë:



- ✓ ***Përdorimi i Teknologjise së informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe përmirësimi i networkut për marketim.***

Duke patur parasysh rolin e madh të vendosjes dhe zhvillimit të kontakteve, në këtë fazë të zhvillimit të ITAP-it, është organizuar puna që Menaxherët e ITAP-it të mbulojnë institucione të ndryshme të qeverisjes qendrore, të jenë përgjegjës dhe të vëzhgojnë se çfarë zhvillohet e re në këto institucione, cilat mund të jenë nevojat dhe cilët janë personat kyç në lidhje me aktivitetet e ITAP-it. Vendosja dhe zhvillimi i këtyre rrjeteve,



është burim shumë i rëndësishëm i identifikimit të nevojave për trajnim, dhe njëkohësisht edhe për përcaktimin e trajnimeve specifike brenda këtyre institucioneve.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2012 është rikonstruktuar faqja elektronike e ITAP-it. Qëllimi kryesor i këtij procesi ka qenë, që të jepet sa më shumë informacion dhe të publikohen të gjitha aktivitetet që ITAP-i organizon. Nëpërmjet kësaj dritareje ITAP-i, promovon produktet që ofrohen sipas grupeve të synuara. Kjo e bën ITAP-in të dukshëm në treg dhe shërben për marketimin më të mirë të tij. Ndërkohë në planet tona të mëtejshme një vend të veçantë do të zërë përdorimi i sistemit të email-it GoVNET për përhapjen e informacionit lidhur me trajnimin i cili do të jetë një hap shumë vendimtar në realizimin e objektivave të përfshira në strategjinë e ITAP-it, dhe në rritjen e aksesit të administratës publike për çështje që lidhen me trajnimet që ITAP-i ofron.

### Programi i trajnimit për vitin 2012

Objektivi kryesor i programit të trajnimit është:

*Të mbështesë një shërbim civil më profesional, të aftë dhe të bazuar në sistemin e meritës, menaxher më të kualifikuar dhe më të përgjegjshëm si dhe një shërbim civil më cilësor dhe më të motivuar për të zbatuar strategjitë kombëtare për zhvillime të mëtejshme në të ardhmen.*

Themelore për këtë program trajnimi është analiza e nevojave për trajnim. Konsultimi dhe mendimet e marra kanë bërë të mundur që programi i trajnimit të lidhet me së miri me nevojat e klientëve kryesore të ITAP-it.

#### ⇒ **Procesi i Trajnimit**

Programi i trajnimit të ITAP-it për vitin 2012, ndarë sipas fushave të përcaktuara në Planin Strategjik, është realizuar duke u fokusuar më shumë në trajnimin e nëpunësve civilë të nivelit qendror, mbi çështjet që kanë lidhje me procesin e Integritimit të vendit në BE.

### **1. Trajnim që lidhet me Procesin e integritimit European**

Vendi ynë është shumë pranë marrjes së statusit të vendit kandidat për në Bashkimin European, që do të thotë më shumë reforma, më shumë angazhime dhe më shumë mbështetje financiare në realizimin e këtyre reformave. Pë këtë arsye dhe trajnimi i administratës është një domosdoshmëri për përmirësimin e cilësisë së përthithjes, menaxhimit dhe monitorimit të projekteve dhe ndihmës së dhënë. Programi i trajnimit në këtë fushë, përfshin kurse trajnimi të hartuara për nëpunës të sapoemëruar në Administratën Publike duke ofruar njohuri dhe informacion mbi historikun e krijimit të Bashkimit European, institucionet kryesore dhe vendimmarrëse të BE-së.



## Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

Për të rritur kapacitetet e nëpunësve të Institucioneve qendrore dhe lokale në programimin dhe zbatimin në të ardhmen të sistemit të decentralizuar të asistencës së BE-së, tashmë me një qasje të re sektoriale, janë organizuar trajnime për nëpunësit që punojnë me hartimin e projektpropozimeve, programimin dhe monitorimin e asistencës së BE-së. Pjesëmarrësit në këto trajnime u njohën me stadin aktual të këtij procesi, rolin dhe përgjegjësitë që mund të kenë institucionet e tyre në të ardhmen.

Pjesëmarrja e stafit të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore në këto trajnime është një garanci më shumë për të patur projekte të mirëpërgatitura, duke plotësuar kështu edhe një kërkesë të BE-së: rritjen e pronësisë së përfituesve për programimin dhe menaxhimin me efektivitet të fondeve të IPA-s.

Përveç përgatitjes për zbatimin e asistencës së BE në kuadrin e Instrumentit të Para-Aderimit, është zhvilluar një kurs trajnimi për hyrje në fondet strukturore të BE.

Tematikat kryesore të trajnimeve në këtë fushë kanë qenë: Menaxhimi i Ciklit të Projekteve; Përgatitja e Termave të Referencës; Monitorimi; Programimi dhe Hartimi i Projekt - Fishave Sektoriale dhe Qasja Sektoriale; Prokurimi dhe kontratimi sipas procedurave PRAG; Qasja Sektoriale; Vlerësimi Institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve sipas metodës CAF"; Menaxhimi mbi bazën e Rezultateve.

***Në total janë zhvilluar 36 kurse, 72 dite trajnimi dhe janë trajnuar 602 nëpunës civilë, të nivelit qendror Trajnimet e kësaj fushe kanë zënë rreth 18 % të totalit të trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2012.***

### **2. Kurse trajnimi mbi SPI-në**

Sistemi i Planifikimit të Integruar është sistem planifikimi në qeverisjen qendrore i cili siguron që buxheti të jetë i lidhur me politikën dhe strategjinë, që fondet publike jo vetëm janë përdorur ekonomikisht me efikasitet dhe efektivitet, por gjithashtu me rezultatet finaciare që përkojnë me prioritetet e Qeverisë. Gjithashtu është e nevojshme që të gjithë nëpunësit civilë që punojnë në administratën qendrore të njohin mirë sistemin dhe elementët e tij.

Paketa e trajnimeve mbi SPI-në përfshin 5 kurrikula, të cilat kanë qëllim:

- të informojnë nëpunësit civilë me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kuptuar dhe zbatuar SPI-në,
- përmirësimin e procesit të lidhjes së politikave me PBA-në dhe prioritetet e integritetit evropian,
- përmirësim të procesit të hartimit zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe strategjive





- Kuptimin dhe zbatimin e procesit të prokurimit.

Këto kurse i adresohen një grupi të gjerë nëpunësish civilë.

Kurrikulat e hartuara në këtë fushë, janë hartuar në përputhje me nevojat për trajnim si edhe me planin strategjik 2011-2013, sipas tematikave: Hartimi i Strategjive me fokus Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2013-2020; Vlerësimi i ndikimi të politikave me fokus mekanizmin e monitorimit bazuar mbi rezultate; Hartimi i programit të investimeve publike, në kuadër të PBA-së dhe analiza e riskut; Hartimi i programit të investimeve publike, në kuadër të PBA-së dhe analiza e riskut; Hartimi i Politikave publike, strategjive dhe monitorimi i tyre .

***Në total janë realizuar 8 kurse trajnimi, 25 dite trajnimi dhe janë trajnuar 159 nëpunës civilë***

### ***3. Trajnime në lidhje me projekt buxhetin afat mesem dhe buxhetin vjetor***

Programi i trajnimit në këtë fushë synon të ofrojë njohuri të përkatëse për nëpunësit civilë në ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, në formën e një trajnimi të avancuar, mbi të gjithë elementet e ciklit të PBA-së, si edhe informacione më të detajuara mbi përgatitjen e buxhetit, monitorimin e tij, legjislacionin përkatës që rregullon menaxhimin e shpenzimeve publike dhe sistemin e buxhetit.

Gjatë këtij viti, ky trajnim është përfshirë në paketën e trajnimeve mbi SPI-në, me fokus dhënien e njohurive të përgjithshme, ndërkohë që në vitin që vjen do të punohet për hartimin e kurrikulave të veçanta dhe zhvillimin e trajnimeve specifike si në nivel qendror edhe në atë lokal. Gjatë këtij viti, është punuar në këtë fushë dhe janë hartuar kurrikulat për temat: Menaxhimi i Financave Publike; Cikli i PBA dhe prokurimi; Monitorimi i programit buxhetor afatmesëm; Reforma në fushën e MKF-së dhe përgjegjësia financiare; Menaxhimi i riskut; parimet dhe konceptet; Gjurma e auditimit etj.

***Në total janë zhvilluar 15 kurse, 34 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 312 nëpunës civilë.***

### ***4. Trajnim në mbështetje të strategjisë së decentralizimit***



## Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

---

Bazuar në kërkesat dhe nevojat e qeverisjes vendore, ITAP-i synon të ofrojë për pjesëmarrësit njohuritë e nevojshme mbi administratën e qeverisjes vendore, procesin e decentralizimit në Shqipëri, buxhetin dhe huamarrjen, mbledhjen dhe menaxhimin e taksave vendore. Qëllimi është të kontribuojë për zhvillimin e kapaciteteve të administratës lokale duke nxitur bashkëpunimin komunal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira/modeleve që egzistojnë në vend. Në këtë fushë është punuar si me mbështetjen e buxhetit të shtetit, ashtu edhe me programe e projekte. Tematikat kryesore të trajtuara në këtë fushë janë: Hartimi i projekteve dhe aplikimi për projekte të bashkëpunimit ndërkufitar; Programi kombëtar i trajnimit të drejtuesve të qeverisjes vendore; Prezantim me administratën publike në nivel lokal (për nëpunësit e sapoemëruar), Aksueshmeria për personat me aftësi të kufizuar dhe realizimi i saj; Etika dhe zbatimi i ligjit për parandalimin e konfliktit të interes, Menaxhimi i financave vendore etj.

***Në këtë fushë janë zhvilluar 80 kurse, 127 dite trajnimi dhe janë trajnuar 1654 nëpunës civilë.***

### ***5. Trajnime të përgjithshme***

Programi i trajnimit ofron njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike, procesin e hartimit të politikave dhe zbatimin efektiv të tyre, zhvillimin e aftësive menaxhuese të orientuara drejt rezultateve të nëpunësve civilë.

**Prezantimi me Administratën Publike** - ky program trajnimi, është i detyrueshëm për nëpunësit e sapoemëruar në administratë, dhe i njeh pjesëmarrësit me disa koncepte themelore mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike dhe shtetit Shqiptar, procedurat administrative, pa lënë mënjane dhe aftësitë profesionale dhe menaxheriale që duhet të këtë nëpunësi civil në përputhje me kërkesat e kohës.

***Gjatë vitit 2012 janë zhvilluar 9 kurse , 99 dite trajnimi dhe janë trajnuar 192 nëpunës civilë.***

Gjithashtu në këtë fushë janë zhvilluar kurse me tematika si: Ligji i konkurrencës në prokurimet publike; Masat disiplinore dhe procedurat e ankesave; Etika dhe antikorrupsioni; Menaxhimi i Kontratave; Hartimi i shkresave dhe komunikimi; Mbrotjtja e të dhënave personale; Masat disiplinore dhe procedurat e ankesave etj.


***Janë zhvilluar 58 kurse, 176 dite trajnimi dhe janë trajnuar 1190 nëpunës civilë.***

**6. Programi trajnues: Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.**

Programi për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore është një mjet për zhvillimin e stafit profesional të BNJ-re. Programi i propozuar i trajnimit ka për qëllim rritjen e aftësive dhe njohurive të nëpunësve civilë punonjës të këtyre drejtorive dhe menaxherëve të linjës për të menaxhuar, zhvilluar dhe për të mbajtur të motivuar nëpunësit civil që janë të aftë dhe të përkushtuar. Gjatë këtij viti, është punuar në këtë fushë dhe janë hartuar kurrikulat për temat: Organizimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore dhe strukturave organizative; Sistemi i regjistrimit të stafit HRM IS; Menaxhimi i burimeve njerëzore.

**Numri i kurseve të zhvilluara është 12, ditë trajnimi 42 dhe nëpunës civilë të trajnuar: 149.**

Grafiku i mëposhtëm paraqet kurset e tranimit të zhvilluara, të ndara sipas fushave.





## **Mbështetje Institucionale dhe Financiare**

### ⇒ **Departamenti i Administratës Publike (Ministria e Brendshme)**

Gjatë vitit 2012, Departamenti i Administratës Publike ka miratuar në vijimësi planin e punës dhe programin e trajnimit dhe ka ndjekur veprimtarinë trajnuese të Institutit duke dhënë sipas rasti, orientimet dhe udhëzimet e duhura.

## **Donatore dhe bashkëpunime me projekte**

### **Delegacioni i Bashkimit Europian**

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, ka vazhduar bashkëpunimin me Delegacionin e Bashkimit Europian edhe gjatë vitit 2012 . ITAP-i ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me tre projekte të financuara nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, sic janë projekti PPF, SMEI III dhe DMS në Ministrinë e Integritimit Europian dhe Ministrinë e Financave me të cilat ka bashkëpunuar me sukses gjatë kësaj periudhe.

#### **- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë**

Me mbështetjen e GIZ edhe gjatë vitit 2012 u zhvilluan trajnime në kuadër të aplikimeve të projektit për bashkëpunim ndërkufitar të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës shkurt – maj 2012, në qarqet e Beratit, Kukësit , Shkodrës, Lushnjës dhe Tiranës.

Gjithashtu gjatë periudhës tetor-dhjetor 2012, po në bashkëpunim me GIZ, ITAP dhe METE në kuadër të programit “Mbështetje për përafrimin dhe implemetimin e ligjeve të BE në legjislacionin Shqipëtar” janë organizuar 15 workshop-e me pjesëmarrës nga grupet e punës dhe me lektorë ndërkombëtar ekspert të fushës. Ky projekt vjen në ndihmë të rritjes së kapaciteteve njerëzore me anë të trajnimeve të cilët do të mbështesin përafrimin e legjislacionit dhe ndërtimin e institucioneve eficiente për këtë pjesë konkrete të kapitujve.

#### **- Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP)**

Programi Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në Shqipëri (UNDP) në kuadrin e disa Programeve në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike kanë vazhduar bashkëpunimin edhe gjatë vitit 2012

Projekti i UNDP "Program Mbështetës për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara" bashkëpunoi me ITAP për të organizuar trajnimin



“Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara dhe masat për realizimin e saj”. Ky trajnim u hartua për përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe vendore që kanë detyrë planifikimin, projektimin, miratimin, zbatimin e monitorimin e ndërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara si dhe të shërbimeve. Ky trajnim synoi të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve për të siguruar objekte e shërbime të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Në Trajnim morën pjesë 32 persona (17 femra), përfaqësues të institucioneve qendrore (ministritë dhe institucionet në varësi) dhe vendore (bashkitë dhe minibashkitë).

#### - UNWOMEN

Gjatë vitit 2012 ITAP ka patur një bashkëpunim të sukseshëm me UNWOMEN. Programi i “**Buxhetimi gjinor i përgjegjshëm, si një mjet për Integrimin Gjinor**” synoi rritjen e kapaciteteve të administratës publike në nivel qendror dhe lokal duke përfshirë parimet e barazise gjinore jo vetëm në politikëbërje, por dhe në buxhetim në nivel qendror. Gjatë periudhës qershor- tetor 2012 u organizuan 10 trajnime me këtë tematikë për nëpunës civilë në nivel lokal dhe qendror. Programi i trajnimit ofroi njohuri specifike për nëpunësit e administratës vendore, me fokus rritjen e njohurive ashtu dhe motivimin e tyre për të aplikuar modelin e integritit gjinor në të gjitha pozicionet ku ata/ato punojnë në drejtim të planifikimit.

Trajnimi u ndoq nga 248 pjesëmarrës (165 femra dhe 83 meshkuj) të cilët përfaqësohen institucionet e mëposhtme:

- i) Qeveria qendrore (65 pjesëmarrësve: 59 femra dhe 6 meshkuj)
- ii) pushteti vendor (183 pjesëmarrësve: 106 femra dhe 77 meshkuj)

#### - Prezenca e OSBE në Shqipëri

Gjatë vitit 2012, ka vazhduar bashkëpunimi me OSBE-në. Kështu janë zhvilluar trajnime me temë; Etika dhe antikorrupsioni; Këto trajnime synuan rritjen e kapaciteteve zyrtarëve të njësive të qeverisjes vendore në dy zona të vendit Berat dhe Ersekë, lidhur me çështje të rëndësishme të veprimtarisë administrative si pa anësia dhe etika; parandalimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesave;- respektimi i të cilave ul korrupsionin në këto njësi dhe rrit besimin e publikut për shërbim të drejtë ndaj interesave të tij.

#### - PPF (Project Preparation Facility)

Ashtu sikurse dhe në vitet e mëparshme, ITAP ka vazhduar bashkëpunimin me projektin PPF pranë Ministrisë së Integritit European, duke zhvilluar një sërë trajnimesh, në kuadër të decentralizimit dhe menaxhimit të fondeve të IPA-s. Këto trajnime u organizuan për të rritur kapacitetet e nëpunësve të Institucioneve qendore



dhe ministrive të linjës në programimin dhe zbatimin e fondeve të BE-së, tashmë me një qasje të re sektoriale, sipas komponentëve III dhe IV.

Gjatë vitit 2012 janë organizuar 9 kurse trajnimi, ku trajnerë ishin trajnerët e certifikuar në vitin 2011 sipas fushave përkatëse, në trajnimin e trajnerëve organizuar në bashkëpunim me Projektin e PPF, ADA dhe ITAP. Gjithsej në këto trajnime u përfshinë 11 trajnerë, të cilët u vlerësuan mjaft mirë dhe nga pjesmarrësit. Trajnimet e organizuara përfshinë tematikat: Menaxhimi i Ciklit të Projekteve; Përgatitja e Termave të Referencës; Monitorimi; Programimi dhe Hartimi i Projekt - Fishave Sektoriale dhe Qasja Sektoriale; Prokurimi dhe kontratimi sipas procedurave PRAG; Qasja Sektoriale; Vlerësimi Institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve sipas metodës CAF"; Menaxhimi mbi bazën e Rezultateve

### - **SMEI III- forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Integritit European**

IPA 2010- SMEI III (Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Integritit):

Qëllimi i këtij projekti është të forcojë kapacitetet teknike dhe administrative të aktorëve kyç në procesin e Integritit European, posaçërisht të Ministrisë së Integritit, ministrive të linjës, agjencive të tjera qeveritare, si dhe autoriteteve që kanë lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe harmonizimin e legjislacionit Shqiptar me *acquis communautaire* dhe akteve të tjera të lidhura me të.

Instituti i trajnimit të administratës publike ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi, qëllimi i së cilit është të vendosë bazat për bashkëpunim midis palëve, të përcaktojë përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë për realizimin e trajnimeve në mbështetje të rritjes së kapaciteteve të MIEU-së në zbatimin e MSA-së dhe kordinimin në kuadrin e bashkëpunimit. Aktivitete trajnuese të SMEI III, u zhvilluan në bashkëpunim me ITAP.

Gjatë vitit 2012 në modulën e kursit të trajnimit "Prezantim me administratën publike" i cili është i detyrueshëm, është shtuar një ditë trajnimi lidhur me procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Tematikat kryesore të trajnimeve janë: kriteret anëtarësimit; procesi i stabilizimit asociimit; procesi i zgjerimit të BE-së dhe marrëdhëniet e BE-së me Shqipërinë.

Me mbështetjen teknike të projektit të asistencës së BE-së për procesin e Integritit në Bashkimin Evropian (faza III, SMEI 3), në bashkëpunim me Ministrinë e Integritit European të Shqipërisë, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) është duke zgjeruar grupin e trajnerëve në fushën e BE-së, në zbatim të strategjisë së trajnimit 2011 - 2013. Në këtë kuadër, në Tetor të vitit 2012, u realizua faza e parë e këtij bashkëpunimi. Kjo fazë përfshiu thirrjen për aplikantë dhe përzgjedhjen e kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara nga ITAP dhe MIE. Mbasi u shqyrtuan të gjitha kandidaturat që shprehën interesin e tyre për t'u bërë trajnerët të ITAP-it, u bë një përzgjedhje e një grupi prej 16 vetash. Trajnerët potencialë do të vijnë në ndihmë gjatë procesit të hartimit, dhe më tej,



kryerjes së kurseve për nëpunësit e administratës publike për çështjet e lidhura me procesin e Integritimit Evropian gjatw vitit 2013 e mw tej pwr çwshtje si:

- Politikat sektoriale të Bashkimit evropian (kapitujt e EU acquis)
- Integrimi evropian për nëpunësit e sapo emëruar

Ky grup i përzgjedhur do të marrë pjesë në një trajnim të avancuar 4 ditor (trajnim trajnerësh), që përbën dhe fazën e dytë të këtij projekti, që do të zhvillohet në fillim të vitit 2013.

⇒ **Inspektoriati i lartë deklarimit të pasurive ILDKP**

